



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-010
Prishtinë, më 2 shkurt 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 2 SHKURT 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljević, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit, Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe
Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 26 janar 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 janar 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 26 janar 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Lidhur me përgatitjet për seancën plenare të radhës, përkatësisht pikën 2.4 të rendit të ditës - Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së, për përgjegjësinë e ministrit Aleksandër Jablanoviq për deklaratat e tij publike, diskutuan: Donika Kadaj-Bujupi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviq, Elmi Reçica, Visar Ymeri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq dhe Sabri Hamiti. Diskutimet e tyre janë dhënë në transkript.

Në fund, Kryesia me shumicë votash vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 5 shkurt 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
4. *Interpelanca e kryeministrit Isa Mustafa, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së për përgjegjësinë e ministrit Aleksandër Jablanoviq për deklaratat e tij publike,*
5. *Projekt-rezoluta për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës,*
6. *Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,*
7. *Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për emërimin e anëtarit në komisionin parlamentar,*
8. *Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarit në komisionin parlamentar.*

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Projekt-rezoluta për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Grupi Parlamentar i AAK-së, i mbështetur nga grupi i deputetëve tjerë nënshkrues, më 23 janar 2015 e ka parashtruar në Kuvend Projekt-rezolutën për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës, por më 29 janar 2015 e ka riproceduar në Kuvend tekstin e riformuluar të Projekt-rezolutës për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Sabri Hamiti dhe Donika Kadaj-Bujupi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, në fund, me propozim të nënkryetarit të Kuvendit, Sabri Hamiti, Projekt-rezolutën për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës e radhiti si pikë nr. 5 të rend të ditës për seancën plenare, që do të mbahet më 5 shkurt 2015.

2. Kërkesa për aprovimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e Asamblesë Parlamentare për procesin e bashkëpunimit në Evropën Juglindore

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendi i Republikës së Kosovës është ftuar të përfaqësohet nga një deputet dhe një koordinator nacional i delegacioneve në punimet e Komisionit Parlamentar për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Bashkëpunim për Sigurinë në Asamblenë Parlamentare të procesit të bashkëpunimit të Evropës Juglindore, që do të mbahen në Turqi, prej 8-10 shkurt 2015.

Ai tha se nga Kryesia e Kuvendit kërkohet që të propozohet dhe caktohet një deputet që do të përfaqësojë Kuvendin e Kosovës në këtë delegacion.

Lidhur me kërkesën e lartpërmendur diskutuan Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën për pjesëmarrje në punimet e Komisionit të lartpërmendur, mori këtë:

Vendim

1. Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, caktohet të marrë pjesë në punimet e Komisionit Parlamentar për Drejtësi, Punë të Brendshme dhe Bashkëpunim për Sigurinë në Asamblenë Parlamentare të procesit të bashkëpunimit të Evropës Juglindore, si dhe zyrtarja nga Administrata e Kuvendit, Merita Drenori, që do të mbahen në Turqi, prej 8-10 shkurt 2015.

2. Shpenzimet e qëndrimit në hotel për të lartpërmendurat në pikën (1) një të këtij vendimi mbulohen nga organizatori - Kuvendi i Madh i Turqisë, ndërsa shpenzimet e udhëtimit, ushqimit, si dhe mëditjet mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Lidhur me caktimin e anëtarëve për të marrë pjesë në punimet e Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Infrastrukturë dhe Energji, si dhe të atij për Zhvillim Social, Edukim, Kërkim dhe Shkencë të Asamblesë Parlamentare për procesin e bashkëpunimit në

Evropën Juglindore, kryetari tha se duhet të vendosë Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e radhës.

3. Kërkesa e kryetares së ish-Grupit të Grave Deputete për vazhdimin e kontratës së asistentes së këtij grupi

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

Kryesia e shtyu për mbledhjen e radhës vendimmarrjen lidhur me kërkesën e kryetares së ish-Grupit të Grave Deputete për vazhdimin e kontratës së asistentes së këtij grupi.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale